




ANKETIM MBI NIVELIN E KENAQESISE ME SHERBIMET POLICORE

Shtator - Tetor 2014

Mbeshtetja e Qeverise Suedeze ndaj Ministrise se Brendshme (MB)/Policise se Shtetit (PSH) Shqiptar per Policimin ne Komunitet

Objektivat e Anketes



- Matja e nivelit te kenaqesise se qytetareve me sherbimet e policise se shtetit.
- Impakti i aktivitetit te policise mbi jeten e perditshme te qytetareve
- Indikatorret e “Kenaqesise”
 - Ndjesia e Sigurise
 - Sa e drejte/e paanshme/e barabarte eshte policia ne trajtimin e qytetareve?
 - Performanca ne parandalimin e krimit
 - Transparenca dhe pergjegjshmeria
 - Gatishmeria e qytetareve per te bashkepunuar me policine
- Rezultate:
 - Nivel Qarku
 - Nivel agregat

Hapi 1

- Perzgjedhja e pikave te kampionimit
- Stratifikim sipas qarkut dhe dimensionit urban/rural

Hapi 2

- Perzgjedhja e familjeve
- Metoda e Rruges Rastesore

Hapi 3

- Perzgjedhja e te anketuarit
- Ditelindja e fundit

Kampioni

❖ 2500 intervista

❖ 300 intervista ne qarkun e Tiranes

❖ 200 intervista/qark

Numri i Intervistave sipas Qarkut

4

Qarku	Intervista
Berati	200
Dibra	200
Durresi	200
Elbasani	200
Fieri	200
Gjirokastra	200
Korca	200
Kukesi	200
Lezha	200
Shkodra	200
Vlora	200
Tirana	300
KOMBETAR	2500

Krahasueshmeria e rezultateve me vendet e tjera Europiane (“European Social Survey”)

5

- Ky anketim eshte kryer nga **IDRA** ne periudhen **Shtator-Tetor 2014** me mbeshtetjen e **SACP Programme** (Mbeshtetja e Qeverise Suedeze ndaj Ministrise se Brendshme (MB)/Policise se Shtetit (PSH) Shqiptar per Policimin ne Komunitet).
- I njeiti anketim eshte kryer edhe rreth nje vit me pare ne periudhen **Gusht – Shtator 2013**.
- Rezultatet e prezantuara ne kete raport jane ‘peshuar’ per te perfaqesuar popullaten statistikisht.

■ ■ ■ ■ **PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE**

VIKTIMIZIMI DHE NDJESIA E SIGURISË

- Gjatë kësaj vale të anketimit mbi kënaqësinë me shërbimet policore, të intervistuarit janë pyetur mbi nivelin e viktimizimit të tyre apo personave të tyre afërm gjatë 5 viteve të fundit. Nga të dhënat vihet re që po e njëjta përqindje e të anketuarve si në valën e kaluar (11%) ka qenë viktimë e ndonjë vjedhjeje, grabitjeje apo sulmi fizik. Duke marrë parasysh Sondazhin Social Evropian, në të cilin krahasohen rezultatet e vendeve Evropiane gjatë kësaj vale, për pyetjen e mësipërme vihet re se Shqipëria nuk ka ndryshim në klasifikim (16%).
- Të anketuarve u është kërkuar të shprehin mendimin e tyre në lidhje me ndjesinë e sigurisë që kanë për të ecur në lagjen e tyre pasi është errësuar. Vihet re se ka një rritje të nivelit të perceptimit të sigurisë në të tilla situata. Gjatë kësaj vale, 3 në 4 persona (76%) janë shprehur të sigurt (31% shumë të sigurt dhe 45 të sigurt) të ecin në errësirë në lagjen e tyre në krahasim me 63% të valës së kaluar. Përveç se përmirësimit në vetvete, ky rezultat e rendit Shqipërinë pak më lartë nivelit Evropian (75%) në bazë të rezultateve të Sondazhit Social Evropian të kësaj vale.
- Rritja e perceptimit mbi nivelin e sigurisë reflektohet gjithashtu edhe nga të dhënat e mbledhura mbi nivelin e shqetësimit të intervistuarve rreth mundësisë së vjedhjes në banesën e tyre dhe mundësisë për të qenë viktimë e ndonjë krimi të dhunshëm. Specifikisht, gjysma e të anketuarve (50%) nuk shqetësohen shpesh se do tu vidhet banesa (16% shqetësohen rrallë dhe 36% nuk shqetësohen asnjëherë) në krahasim më 40% të valës së kaluar. Gjithashtu, 71% e të intervistuarve nuk shqetësohen shpesh rreth mundësisë për të qenë viktimë e ndonjë krimi të dhunshëm (17% rrallë dhe 54% asnjëherë), në krahasim më 50% të valës së kaluar.

NDËRGJEGJËSIMI RRETH SHKELJEVE TË NDRYSHME

- Të intervistuarit janë pyetur nëse konsiderojnë si të gabuar ose jo kryerjen e veprimeve të ndryshme si bërja e një kërkesë të ekzagjeruar apo të rremë për dëmshpërblim nga siguracioni, blerja e një sendi të vjedhur apo shkelja e semaforit dhe rregullave të qarkullimit rrugor. Nga të dhënat vihet re se në përgjithësi ka një rritje të ndërgjegjësimit nga ana e të intervistuarve në lidhje me çfarë është e gabuar.
- Më pas të anketuarve u është kërkuar të japin vlerësimin e tyre rreth aftësisë së institucioneve në përmbushjen e detyrave të tyre për zbatimin e ligjit në situata e sipërpërmendura. Nga të dhënat vihet re se ka një rritje në ndërgjegjësimin e të intervistuarve se në raste shkeljesh do të ketë pasoja dhe ndëshkime nga strukturat përkatëse.
- Specifikisht, në rastin e bërjes së një kërkesë të ekzagjeruar apo të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni, 57% e të intervistuarve pohojnë se ka mundësi të kapen apo dënohen (35% ka mundësi dhe 22% ka shumë mundësi), në krahasim me 50% të valës së kaluar. Renditja e Shqipërisë është përmirësuar me disa pozicione në shkallë Evropiane, sipas Sondazhit Social Evropian, duke u afruar drejt nivelit mesatar Evropian.
- Në rastin e bërjes së një sendi të vjedhur, 50% e të anketuarve (33% ka mundësi dhe 17% ka shumë mundësi) pohojnë se ka mundësi të kapen ose dënohen, në krahasim me 40% të valës së kaluar. Rreth 69% e të intervistuarve pohojnë se ka mundësi të kapen apo dënohen nëse thyejnë rregullat e qarkullimit rrugor (39% ka mundësi dhe 30% ka shumë mundësi), një shifër me e lartë se 55% i valës së kaluar.

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E POLICISË SË SHTETIT

- Të pyetur nëse Policia e Shtetit ka ose jo kompetenca për të ndërmarrë veprime (aksione) të ndryshme, vihet re një rritje në nivelin e të intervistuarve që mendojnë se është detyra e Policia e Shtetit të ndërhyjë në të tilla raste. Kjo rritje në perceptim mund të jetë si rezultat i aksioneve të shumta të ndërmarra nga Policia e Shtetit gjatë 12 muajve të fundit.
- Specifikisht, në këtë valë 87% e të anketuarve mendojnë se është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet zënies së trotuareve në mënyrë të paligjshme, në krahasim më 66% nga vala e kaluar. Në 84% të rasteve të intervistuarit mendojnë se është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e ndërtimeve pa leje të shtëpive apo godinave, një shifër e lartë në krahasim me 63% e valës së kaluar.
- Në të njëjtën linjë, vihet re se gjatë kësaj vale 72% e të anketuarve pohojnë se në rastet e mos-pagimit të tatimeve nga ana e bizneseve, është kompetenca e Policisë së Shtetit të marrë masa, në krahasim me 58% nga vala e kaluar. Gjithashtu gjatë kësaj vale ka pasur rritje të numrit të anketuarve që mendojnë se në rastet e shqetësimit të qytetarëve për shkak të zhurmës nga klubet e natës, është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë (97% të kësaj vale krahasuar më 84% të valës së kaluar).

VLERËSIMI I PUNËS SE POLICISË SË SHTETIT DHE TRAJTIMI I GRUPEVE TË NDRYSHME SHOQËRORE

- Të pyetur rreth cilësisë së punës së Policisë së Shtetit, vihet re një rritje e konsiderueshme nga vala e kaluar në besimin se Policia e Shtetit është duke bërë një punë të mirë. 3 në 4 të intervistuar (73%) janë të mendimit se Policia e Shtetit është duke punuar mirë, një shifër e lartë po të krahasohet me 36% e valës së kaluar.
- Nga të dhënat e 2014 vihet re se gjatë kësaj vale nuk ka pasur ndryshim në numrin e të intervistuarve që kanë pasur kontakt me Policinë e Shtetit në 2 vitet e fundit. Pra mund të thuhet që në tërësi rritja e ndjesisë së sigurisë, ndërgjegjësimit për veprime të gabuara apo edhe vlerësimi i punës së Policisë së Shtetit vjen si pasojë e perceptimit të jashtëm publik rreth shërbimit të këtij institucioni.
- Të anketuarve që kanë pasur kontakt me Policinë e Shtetit gjatë 2 viteve të fundit u është kërkuar një vlerësim rreth mënyrës se si janë trajtuar nga punonjësit e këtij institucioni. Vihet re se ka një rritje të numrit të intervistuarve që kanë mbetur të kënaqur nga kontakti i fundit. Gjatë kësaj vale, rreth 45% e atyre që kanë pasur kontakt kanë mbetur të kënaqur (24% të kënaqur dhe 21% shumë të kënaqur), në krahasim me 32% të valës së kaluar. Sipas Sondazhit Social European të kësaj vale, me këtë rezultat Shqipëria fiton pozicione në renditje dhe afrohet drejt mesatares Evropiane.

Përmbledhje Ekzekutive (5)

11

- Të intervistuarve u është kërkuar gjithashtu të japin mendimin e tyre në lidhje me mënyrën se si Policia e Shtetit trajton shtresa (grupe) të ndryshme shoqërore. Në tërësi ka një rritje të perceptimit se Policia e Shtetit i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë.
- Specifikisht, kur janë pyetur për mënyrën e trajtimit të personave të varfër në krahasim me personat e pasur, gjatë kësaj vale, rreth 34% e të intervistuarve (1 në 3) mendojnë se Policia e Shtetit i trajton njësoj, në krahasim me 24% të valës së kaluar. Edhe pse ka një rritje në këtë aspekt, numri i personave që mendojnë të kundërtën është ende i lartë (58%). Në rang Evropian Shqipëria fiton pozicione në renditje duke iu afruar mesatares së shteteve Europiane.
- Kur janë pyetur nëse Policia e Shtetit i trajton me keq disa grupe njerëzish për shkak të racës apo etnisë që i përkasin, gjatë kësaj vale 55% e të intervistuarve mendojnë se të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht racës apo grupit etnik. Kjo shifër përbën një përmirësim nga vala e kaluar (31%).

- Sondazhi i 2014 tregon një rritje të konsiderueshme në 60 pikë (+12 pike nga vala e 2013) të nivelit të vlerësimit nga të intervistuarit të suksesit të Policisë së Shtetit në parandalimin e krimeve ku është përdorur dhunë ose ka kërcënim për dhunë. Rezultatet e kësaj vale tregojnë gjithashtu se vlerësimi për këtë dimension është mbi mesataren (50 pikë), gjë që tregon se Policia e Shtetit momentalisht shihet si relativisht “e suksesshme” në parandalimin e ngjarjeve të tilla.
- Të intervistuarit janë pyetur edhe për vlerësimin e tyre për suksesin e Policisë së Shtetit në arrestimin e personave të akuzuar për vjedhje. Në këtë aspekt, vihet re një përmirësim prej 7 pikësh, krahasuar me rezultatet e valës së kaluar (nga 46 pikë në 53 pikë). Vlerësimi mbi mesataren, edhe në këtë rast tregon se Policia e Shtetit shihet nga qytetarët si përgjithësisht e suksesshme në misionin e saj për arrestimin e shkelësve të ligjit.
- Vlerësimi i të intervistuarve në 2014 për shpejtësinë e mbërritjes në vendngjarje të Policisë së Shtetit nëse do të ndodhte një vjedhje apo një krim i dhunshëm pranë shtëpisë së tyre, në një shkallë nga 0 deri 100 (ku 0 është “jashtëzakonisht ngadalë” dhe 10 është “jashtëzakonisht shpejt”), ka një përmirësim prej 12 pikësh nga vala e kaluar (nga 48 pikë në 60 pikë). Vlerësimi mbi mesataren i këtij dimension i 2014 tregon se qytetarët aktualisht e vlerësojnë si të suksesshme Policinë e Shtetit në këtë aspekt. Ndërkohë, si pasojë e rezultateve në rang kombëtar, Shqipëria ka shënuar gjithashtu një përmirësim të ndjeshëm në klasifikimin e Sondazhit Social European, përsa i përket këtij dimension të punës së Policisë së Shtetit, duke u klasifikuar mbi mesataren Europiane.

- Rezultatet e sondazhit në 2014 tregojnë gjithashtu për një rritje të konsiderueshme të numrit të qytetarëve të cilët mendojnë se Policia e Shtetit në Shqipëri i trajton njerëzit me respekt, krahasuar me shifrat e 2013. Më specifikisht, në 2014, vihet re një rritje prej 21% i numrit të intervistuarve që mendojnë se Policia e Shtetit i trajton njerëzit me respekt. Megjithatë, numri i personave të cilët mendojnë se Policia e Shtetit i trajton njerëzit me respekt “rrallë” apo “shumë rrallë”, vijon të ngelet relativisht i lartë (46%), pavarësisht një trendi në rënie krahasuar me 2013.
- Numri i të intervistuarve në 2014, të cilët mendojnë se Policia e Shtetit “shpesh” ose “shumë shpesh” merr vendime të drejta dhe të paanshme, ka pësuar gjithashtu një rritje të ndjeshme nga vala e kaluar (+18%). Megjithatë, numri i personave të cilët mendojnë se “rrallë” ose “shumë rrallë” Policia e Shtetit merr vendime të paanshme vazhdon të jetë i lartë (45%). Kjo tregon se një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve dyshojnë në aftësinë/vullnetin e Policisë së Shtetit për të trajtuar të gjithë qytetarët njësoj.
- Ndërkohë, Shqipëria ka shënuar një përmirësim të lehtë me 2 pozicione krahasuar me vitin 2013, në klasifikimin e bërë sipas rezultateve të Sondazhit Social European për këtë dimension të punës së Policisë së Shtetit. Megjithatë, rezultatet e Shqipërisë mbeten ende larg mesatares Europiane.

Përmbledhje Ekzekutive (8)

14

- Rezultatet e sondazhit të 2014, tregojnë gjithashtu për një rritje të ndjeshme nga vala e kaluar (+18%), të numrit të intervistuarve të cilët mendojnë se Policia e Shtetit “shpesh” ose “shumë shpesh” merr vendime të drejta dhe të paanshme. Megjithatë, numri i personave të cilët mendojnë se “rrallë” ose “shumë rrallë” Policia e Shtetit merr vendime të paanshme vazhdon të jetë i lartë (45%). Sipas rezultateve të Sondazhit Social European, Shqipëria shënon një përmirësim të lehtë (2 pozicione) në renditjen e përgjithshme për këtë dimension të punës së Policisë së Shtetit në 2014.
- Gjatë kësaj vale rreth 40% e të intervistuarve në Shqipëri mendon se Policia e Shtetit në përgjithësi i shpjegon “shpesh” ose “shumë shpesh” vendimet/veprimet e saj “, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm nga 2013 (+16%). Në të njëjtën kohë, një numër i konsiderueshëm prej 41% e të intervistuarve në 2014, ende mendojnë se Policia e Shtetit “rrallë” ose “shumë rrallë” i shpjegon veprimet e saj. Ky rezultat tregon për një mangësi të perceptuar të komunikimit të Policisë së Shtetit me qytetarët.

SJELLJA KUNDREJT VEPRIMEVE TË POLICISË SË SHTETIT

- Rezultatet e 2014 nxjerrin gjithashtu në pah një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve përsa i përket mbështetjes nga ana e tyre të vendimeve të Policisë së Shtetit edhe kur nuk pajtohen me to. Shumica e qytetarëve e shohin mbështetjen e vendimeve të Policisë së Shtetit si detyrë të tyre, duke shënuar një përmirësim prej 14 pikësh krahasuar me 2013. (Në një shkallë nga 0 deri 100 ku 0 është “Aspak detyra ime” dhe 100 është “Plotësisht detyra ime”)
- E njëjta qasje vihet re në lidhje me gatishmërinë e qytetarëve për të bërë atë që thotë Policia e Shtetit edhe kur nuk i kuptojnë, ose nuk pajtohen me arsyet e dhëna nga kjo e fundit. Rezultatet e 2014 tregojnë se qytetarët e konsiderojnë më tepër si detyrë të tyre të bërit e asaj që ju kërkon Policia e Shtetit, duke shënuar një përmirësim prej 19 pikësh me 2013 (nga 45 në 64 pikë).
- Vihet re një përmirësim edhe në gatishmërinë e qytetarëve për të bërë atë që ju thotë Policia e Shtetit edhe nëqoftëse nuk e pëlqejnë mënyrën se si ata trajtohen nga kjo e fundit. Rezultatet e 2014 tregojnë për një përmirësim prej 13 pikësh (nga 43 në 56) në krahasim me 2013, përsa i përket vlerësimit nga qytetarët si detyrë, të bërit e asaj që kërkohet nga Policia e Shtetit pavarësisht mënyrës si trajtohen nga ajo.

Përmbledhje Ekzekutive (10)

16

- Rezultatet e 2014 tregojnë për një rritje të konsiderueshme të numrit të të intervistuarve të cilët mendojnë se Policia e Shtetit ndan të njejtën mendim me ta mbi atë se çfarë është e gabuar dhe e drejtë. Numri i personave të cilët janë “dakord” ose “shumë dakord” me pohimin e mësipërm në 2014, shënon një rritje prej +27% (nga 30 në 57%) në krahasim me 2013.
- Rezultatet tregojnë gjithashtu për një rritje të konsiderueshme të numrit të intervistuarve të cilët mendojnë se Policia e Shtetit mbështet parimet dhe vlerat që janë të rëndësishme për ta. Në krahasim me 2013, rezultatet tregojnë një rritje prej 34% të numrit të intervistuarve të cilët janë “dakord” ose “shumë dakord” me pohimin e mësipërm.
- Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të ndjeshme në shumicën e dimensioneve të punës së Policisë së Shtetit në 2014, 66% e të intervistuarve ende mendon se vendimet/veprimet e kësaj të fundit janë të influencuara nga presionet politike. Rezultatet për këtë dimension janë pothuajse të njëjta me ato të 2013, që tregon se shumica e qytetarëve ende mendon se Policia e Shtetit është nën ndikimin e politikës. Në këtë aspekt, renditja e Shqipërisë për këtë dimension krahasuar me vendet e tjera, sipas Sondazhit Social Europian (European Social Survey) nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga 2013, duke u pozicionuar përkrah Bullgarisë dhe Greqisë, ende mjaft larg mesatares Europiane.

POLICIMI NË KOMUNITET

- Policimi në komunitet mbetet term i panjohur për 92% të të intervistuarve në 2014. Krahasuar me 2013, rezultatet tregojnë një rritje prej vetëm 3% të numrit të atyre që kanë dëgjuar për këtë term (nga 5% në 8%). Megjithatë, gjatë kësaj vale, një shumicë e konsiderueshme prej 89% e atyre që deklarojnë se janë në dijeni të policimit në komunitet mendojnë se ky i fundit do të ketë një ndikim “pozitiv” ose “shumë pozitiv” në përmirësimin e jetës në lagjet e tyre. Ky rezultat tregon një rritje të lehtë (+8%) krahasuar me të njëjtin dimension në 2013. Rezultatet tregojnë për nevojën e intensifikimit të fushatave informuese për publikun mbi përfitimet nga policimi në komunitet nga Policia e Shtetit.
- Të intervistuarit janë pyetur edhe për vlerësimin e tyre mbi sa shpesh Policia e Shtetit pranon ryshfete në Shqipëri. Rezultatet e sondazhit të 2014 tregojnë një përmirësim të ndjeshëm me 15 pikë (nga 74 në 59) të vlerësimin të qytetarëve për shpeshësinë e pranimit të rryshfetit nga Policia e Shtetit në krahasim me 2013, në një mesatare nga 0 deri në 100 (0 është “Kurrë” dhe 10 është “Gjithmonë”).
- Përsa i përket klasifikimit sipas rezultateve të Sondazhit Social European për vendet e tjera të Europës për këtë dimension, rezultatet kombëtare në Shqipëri tregojnë një përmirësim prej 3 pozicionesh, megjithëse mbeten ende larg mesatares Europiane.

- Në 2014 vihet re një rritje e numrit të të intervistuarve të cilët do të ishin të gatshëm të thërrisnin Policinë nëse do të ishin dëshmitarë të një vjedhjeje apo një akti dhune në rrugë. Ky dimension, në krahasim me 2013 shënon një rritje prej +13%. Në të njëjtën kohë, numri i të intervistuarve të cilët deklarojnë se ka “pak” ose “shumë pak” mundësi që ta bënin diçka të tillë është përsëri relativisht i lartë (36%), megjithëse në rënie të ndjeshme nga 2013.
- Sondazhi i 2014 gjithashtu tregon për një rritje të numrit të intervistuarve të cilët do të ishin të gatshëm të identifikonin personin i cili ka bërë shkeljet e mësipërme. Në krahasim me 2013, rezultatet tregojnë një rritje prej +18% të qytetarëve të cilët do të ishin të gatshëm të bënin një gjë të tillë. Pavarësisht kësaj, numri i të intervistuarve të cilët shprehen “aspak të gatshëm” ose “jo të gatshëm” për ta kryer një veprim të tillë vijon të ngelet i lartë, në nivelin e 40%. Në renditjen e Sondazhit Social European (European Social Survey), Shqipëria, pavarësisht përmirësimeve në rang kombëtar, nuk shënon asnjë ndryshim në klasifikim krahasuar me 2013, duke u pozicionuar ende larg mesatares Europiane.

Përmbledhje Ekzekutive (13)

19

- Përsa i përket gatishmërisë së të intervistuarve për të dhënë dëshminë në gjykatë kundër të akuzuarve, vihet re një rritje me +15% nga vala e kaluar i numrit të atyre që shprehen “të gatshëm” apo “shumë të gatshëm” për ta bërë një veprim të tillë. Megjithatë, ende 47% e të intervistuarve në 2014 shprehen “aspak i gatshëm” ose “jo shumë i gatshëm” për ta ndërmarrë një veprim të tillë.
- Në klasifikimin e Sondazhit Social European (European Social Survey), Shqipëria shënon një përmirësim të lehtë me dy pozicione në këtë dimension. Megjithatë, Shqipëria mbetet ende larg mesatares Europiane përsa i përket gatishmërisë së qytetarëve për të identifikuar shkelësit e ligjit në gjykatë.




REZULTATET E STUDIMIT

Nivel Kombëtar dhe Sondazhi Social European

A1 (C5).


Në 5 vitet e fundit, a keni qenë ju ose nje anetar i familjes suaj, viktimë e ndonjë vjedhjeje apo sulmi fizik?

21




C5.

Në 5 vitet e fundit, a keni qenë ju ose nje anetar i familjes suaj, viktimë e ndonjë vjedhjeje apo sulmi fizik?




Sa i sigurt ndiheni kur e cni vetëm në lagjen tuaj pasi është errësuar?


■ Shume i sigurt ■ I sigurt ■ I pasigurt ■ Shume i pasigurt




Sa i sigurt ndiheni kur e cni vetëm në lagjen tuaj pasi është errësuar?



Sa shpesh shqetësoheni se mos ju vidhet shtëpia?



Sa shpesh shqetësoheni se mos bëheni viktimë e ndonjë krimi të dhunshëm?




D1.

Sa gabim është të bësh një kërkesë të ekzagjeruar apo të rreme për dëmshpërblim nga siguracioni?

27

■ Aspak e gabuar ■ Deri diku e gabuar ■ E gabuar ■ Plotesisht e gabuar ■ (Nuk e di)




D2.

Sa gabim është të blesh diçka që ju mendoni se mund të jete vjedhur?

28

■ Aspak e gabuar ■ Deri diku e gabuar ■ E gabuar ■ Plotesisht e gabuar ■ (Nuk e di)




D3.

Sa gabim është të bësh një shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor si tejkalim shpejtësie apo kalim semafori me dritë të kuqe?

29

■ Aspak e gabuar ■ Deri diku e gabuar ■ E gabuar ■ Plotesisht e gabuar ■ (Nuk e di)




D4.

Sa mundesi ka qe ju te kapeni dhe te denoheni ketu ne Shqiperi nese beni nje kerkese te ekzagjeruar apo te rreme per dëmshpërblim nga siguracioni?

30

■ Nuk ka fare mundesi ■ Ka pak mundesi ■ Ka mundesi ■ Ka shume mundesi ■ (Nuk e di)




D5.

Sa mundesi ka qe ju te kapeni dhe te denoheni ketu ne Shqiperi nese blini diçka që ju mendoni se mund të jete vjedhur?

31


■ Nuk ka fare mundesi ■ Ka pak mundesi ■ Ka mundesi ■ Ka shume mundesi ■ (Nuk e di)



D5.

Sa mundesi ka qe ju te kapeni dhe te denoheni ketu ne Shqiperi nese blini diçka qe ju mendoni se mund të jete vjedhur?

% e “Nuk ka fare mundesi”




D6.

Sa mundesi ka qe ju te kapeni dhe te denoheni ketu ne Shqiperi nese shkeln rregullat e qarkullimit rrugor si tejkalim shpejtësie apo kalim semafori me dritë të kuqe?


33

■ Nuk ka fare mundesi ■ Ka pak mundesi ■ Ka mundesi ■ Ka shume mundesi ■ (Nuk e di)



A është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e zënies së trotuareve në mënyrë të paligjshme nga lokalet apo baret?


34




PS1b.

A është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e Ndërtimit pa leje të shtëpive/godinave?


35



A është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e Mos-pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare nga ana e bizneseve?



A është detyra e Policisë së Shtetit të ndërhyjë në rastet e shqetesimit të qytetareve për shkak të zhurmës së lartë nga klubet e nates?




D7.

Duke patur parasysh te gjitha detyrat qe ka Policia e Shtetit, do te thoni se ata jane duke bere nje pune te mire apo nje pune te keqe ?

38


■ Punë të mirë / sh. mire ■ Punë as të mirë as të keqe ■ Punë të keqe / sh. të keqe ■ (Nuk e di / Refuzon)



D8.

Ne 2 vitet e fundit, a keni patur kontakte me Policine e Shtetit, a ju ka ndaluar ose a ju ka kontaktuar, per cfaredolloj aresye?

39




D9.

Sa te kenaqur jeni ndjere per menyren se si ju ka trajtuar Policia e Shtetit heren e fundit kur ky kontakt apo ndalim ka ndodhur?


40

■ Shume i pakënaqur ■ I pakënaqur ■ As i pakënaqur as dhe i kënaqur ■ I kënaqur ■ Shume i kënaqur ■ (Nuk e di)



D9.


Sa te kenaqur jeni ndjere per menyren se si ju ka trajtuar Policia e Shtetit heren e fundit kur ky kontakt apo ndalim ka ndodhur?




D10.

Kur viktimat e ndonje krimi raportojne te Policia e Shtetit, a mendoni se Policia e Shtetit i trajton me keq te pasurit, me keq te varfrit apo i trajton njesoj se te pasurit ashtu edhe te varfrit?

42




Kur viktimat e ndonje krimi raportojne te Policia e Shtetit, a mendoni se Policia e Shtetit i trajton me keq te pasurit, me keq te varfrit apo i trajton njesoj se te pasurit ashtu edhe te varfrit ?



D11.

Kur viktimat e ndonje krimi raportojne te Policia e Shtetit, a mendoni se Policia e Shtetit i trajton disa grupe njerzish me keq per shkak te races apo grupit etnik qe i perkasin apo i trajton te gjithë ne menyre te barabarte?

44





D12.

Sa e sukseshme mendoni se eshte Policia ne parandalimin e krimeve ku eshte perdorur dhune ose ka kerccenim per dhune?

45

■ Shume e pasuksesshme ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Shume e sukseshme





D13.

Sa e sukseshme mendoni se eshte Policia e Shtetit ne arrestimin e personave te akuzuar per vjedhje?

46

■ Shume e pasuksesshme ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Shume e sukseshme





D14.

Nëse do te ndodhte një krim i dhunshëm apo vjedhje shtëpie pranë vendit ku ju banoni dhe thërritet Policia e Shtetit, ne mendimin tuaj, Sa shpejt do te arrije ajo ne vendin e krimit?

47


■ Jashtezakonisht Ngadale ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Jashtezakonisht Shpejt



D14.

Nëse do të ndodhte një krim i dhunshëm apo vjedhje shtëpie pranë vendit ku ju banoni dhe thërritet Policia e Shtetit, ne mendimin tuaj, Sa shpejt do të arrije ajo ne vendin e krimit?

Jashtezakonisht
Shpejt




Jashtezakonisht
Ngadale

D15.

Bazuar në atë që ju keni dëgjuar apo përvojën tuaj, sa shpesh do te thoni se Policia e Shtetit i trajton njerëzit me respekt ne Shqiperi?


49




D16.

Sa shpesh do te thonit se Policia e Shtetit merr vendime te drejta dhe te paanshme ne rastet/ngjarjet me të cilat merret?

50




Sa shpesh do te thonit se Policia e Shtetit merr vendime te drejta dhe te paanshme ne rastet/ngjarjet me te cilat merret?



D17.

Në marrëdhënie me qytetarët/njerëzit, sa shpesh do të thonit se Policia e Shtetit në Shqipëri në përgjithësi i shpjegon vendimet dhe veprimet e saj kur kjo i kërkohet?

52





D18.

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare për të Mbështetur vendimet e marra nga Policia e Shtetit edhe kur ju nuk pajtoheni me to?

53

■ Aspak detyra ime ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Plotësisht detyra ime





D19.

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare për të bërë atë që ju thotë Policia e Shtetit edhe nëse ju nuk i kuptoni ose nuk pajtoheni me arsyet?

54

■ Aspak detyra ime ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Plotësisht detyra ime





D20.

Deri në çfarë mase mendoni se është detyra juaj qytetare për të bërë atë çfarë ju thotë Policia e Shtetit të bëni, edhe në qoftë se ju nuk e pëlqeni mënyrën se si ata ju trajtojnë?

55

■ Aspak detyra ime ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Plotësisht detyra ime




D21.

Në përgjithësi Policia e Shtetit ndan mendim të njëjtë për të drejtën dhe të gabuarën ashtu sikurse unë.


56

■ Plotësisht Dakord ■ Dakord ■ As dakord, as jo dakord ■ Jo Dakord ■ Aspak dakord ■ (Nuk e di)



Policia e Shtetit mbështet parimet dhe vlerat që janë të rëndësishme për njerëz si unë.

■ Plotësisht Dakord ■ Dakord ■ As dakord, as jo dakord ■ Jo Dakord ■ Aspak dakord ■ (Nuk e di)




D23.

Në përgjithësi unë e mbështes mënyrën se si Policia e Shtetit vepron zakonisht.


58

■ Plotësisht Dakord ■ Dakord ■ As dakord, as jo dakord ■ Jo Dakord ■ Aspak dakord ■ (Nuk e di)




Vendimet dhe veprimet e Policisë së Shtetit janë të influencuara në mënyrë të padrejtë nga presionet e partive politike dhe politikanëve.

■ Plotësisht Dakord ■ Dakord ■ As dakord, as jo dakord ■ Jo Dakord ■ Aspak dakord ■ (Nuk e di)




Vendimet dhe veprimet e Policisë së Shtetit janë të influencuara në mënyrë të padrejtë nga presionet e partive politike dhe politikaneve.



PS2.

A keni degjuar per 'Policimin ne komunitet'?


61



PS4.



Cfare ndikimi mendoni se do te ketë 'Policimi ne Komunitet' ne permiresimin e jetës se qytetareve ne zonën tuaj?

62




Sa shpesh do të thoni se Policia e Shtetit në Shqipëri pranon ose kërkon rryshfet?

■ Kurre ■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ [5] ■ 6 ■ 7 ■ 8 ■ 9 ■ Gjithmone




